



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK

UDHËZIM

Nr. 02, datë 24.04.2017

“Për një ndryshim në Udhëzimin e Agjencisë së Prokurimit Publik Nr. 3, datë 27.01.2015 “Për Procedurën e Prokurimit me Vlerë të Vogël”, të ndryshuar

Agjencia e Prokurimit Publik (në vijim “APP”), në mbështetje të nenit 13 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 40, Kreu IV dhe nenit 83, Kreu XII të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, si dhe pikës 4 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 918, datë 29.12.2014 “Për kryerjen e procedurave të prokurimit publik në mënyrë elektronike”,

Vendosi:

Në Udhëzimin e APP Nr. 3, datë 27.01.2015 “Për Procedurën e Prokurimit me Vlerë të Vogël”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

1. Pika 5, paragrafi 9, me këtë përmbajtje: *“Kur Autoriteti Kontraktor kalon tek ofertuesi i renditur në vend të dytë dhe në vijim, ka detyrimin ta njoftojë atë menjëherë nëpërmjet sistemit elektronik (menusë së mesazheve), mbi klasifikimin e ri të procedurës”*, shfuqizohet.
2. Pika 5, paragrafi 11, ndryshon si vijon: *“Në rast të pamundësisë së realizimit të objektit të prokurimit, operatori ekonomik te skedari “Kërkesat e Mia” duhet të lajmërojë autoritetin kontraktor brenda afatit të përcaktuar në ftesën për ofertë. Në njoftim duhet të jepen arsyet, që kanë shkaktuar pamundësinë e realizimit të objektit”*.
3. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Eduard Ahmeti

